



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:272962

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645723

KPPP.nr. 338/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Schiedel” d.o.o., me seli në Beograd, Republika e Serbisë, kundër debitorit NTP “Dervishi”, me seli në Vushtrri, rr. “Bahri Kuçi”, nr. 36, me bazë përmbarimi sipas titullit ekzekutiv, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit “Schiedel” d.o.o., me seli në Beograd, Republika e Serbisë dhe debitorit NTP “Dervishi”, me seli në Vushtrri.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Aktvendimin E.nr. 70/07, të datës 28.02.2007, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit për pagesën e detyrimit sipas titullit ekzekutiv në lartësi prej EUR 7,150.00. Ndërsa, e njëjta gjykatë me aktvendimin E.nr. 70/07, të datës 23.03.2016 është shpallur jo kompetente për të vendosur në

këtë çështje përmbare, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr. 114/16, të datës 16.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbare.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Mitrovicë, Dega Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbare është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbare, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbare (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbare, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbare. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimi dhe ankesës kundër vendimeve të përmbare për përmbarimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt zbatimin e përmbare sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbare i cili ka marr formë të prerë, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbare të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13,

pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit i formës së prerë nga gjykata si organ përmbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 338/24, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.